

Thirrja nga data 14.08.2025 deri në datën 21.08.2025

## TERMAT E REFERENCËS PËR BLERJE LAPTOPI

|                   |                                                                                                                                                                                                                  |
|-------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Organizata</b> | OJQ "NEVO KONCEPTI"                                                                                                                                                                                              |
| <b>Objektiva</b>  | Blerje laptopi për koordinatorin e projektit për zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të projektit "Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës". |

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikur se në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian.

### 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

Projekti "Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës", financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim, dhe i cili implementohet nga Save the Children Kosova/o (SCiK) dhe partnerët e saj të projektit, synonë të fuqizojë vajzat dhe djemtë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian me njohuri, kapacitet, aftësi dhe mundësi për të kaluar në moshën madhore, si dhe me punë dinjitoze, të denjë dhe të qëndrueshme. Duke përfshirë shtatë komuna në Kosovë, projekti përdor një strategji me shumë nivele që përfshin ndërhyrje në nivelin e fëmijës dhe familjes, shkollës, komunës, tregut të punës dhe në nivel kombëtar. OJQ Nevo Koncepti nga tetori 2023, ka filluar të zbatojë projektin "Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës" në Komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

Projekti është i shtritur në dymbëdhjet shkolla në tre komunat e cekura më lartë, nga ky numër në gjashtë shkolla fillore të mesme të ulta dhe gjashtë shkolla të mesme të larta profesionale. Kryesisht aktivitetet e projektit janë në lidhje me fuqizimin e nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në vazhdimsinë e shkollimit, orientim në karrierë dhe përgatitje e qëndrueshmërisë në tregun e punës.

## 2. OBJEKTIVA

Një nga objektivat e projektit është edhe zhvillimi i kapaciteteve organizative për partnerët e projektit. Në kuadër të këtij objekti, OJQ “Nevo Koncepti” është në kërkim të mbledhjes së ofertave për blerjen e një laptopi, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të projektit duke siguruar profesionalizëm dhe standarde të larta cilësie.

OJQ “Nevo Koncepti” fton të gjitha kompanitë e interesuara, të cilat ofrojnë pajisje kompjuterike, të paraqesin ofertat e tyre për blerjen e një laptopi, duke u bazuar në specifikat e performancës së kërkuar.

## 3. KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR BLERJEN E LAPTOPIT

**3.1 .Specifikacionet Teknike ( Ofertat e ofruara për laptop duhet të i mbahet këtyre përfomancave për laptop si më posht):**

- a) Ram: 16 GB
- b) Memoria: 256 deri 512 GB – SSD
- c) Madhësia: Notbook 13 -15 inç

**3.2 Procedurat e prokurimit dhe dokumentet që duhet dorëzuar:**

- a. Përshkrim teknik i detajuar dhe i qartë i modelit të ofruar të laptopit.
- b. Ofertë financiare që përfshin çmimin, afatin e dorëzimit dhe detajet e garancisë.
- c. Të ofroj dokumentin e ARBK-s me informacione rreth kompanisë aplikuese, të regjistruar me licencë për shitjen e pajisjeve IT.
- d. Logarinë Bankare (pas njoftimit për përzgjedhje).

**3.3 Kriteret e Vlerësimit (Ofertat do të vlerësohen sipas këtyre kriterëve):**

- a) Përputhshmëria me specifikimet teknike – 40%
- b) Konkurrueshmëria e çmimit – 30%
- c) Garancia – 20%
- d) Afati i dorëzimit – 10%

#### 4. AFATI KOHORË

Thirrja për ofertim fillon me datën **14.08.2025** dhe zgjat deri më **21.08.2025**

#### 5. INFORMACIONE PËR PAGESËN

- Nevo Koncepti do të paguaj Kompanin përzgjedhëse bazuar në faturën e lëshuar pa TVSH.
- Nevo Koncepti do të kryejë pagesën përmes transferit bankar në llogarinë bankare.

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 21.08.2025** në email: [prokurimi@nevokoncepti.org](mailto:prokurimi@nevokoncepti.org) apo në formë fizike në selin e OJQ''Nevo Koncepti'' në adresën Rr.Adnan Krasniqi nr.149, hyrja II Nr.8 Prizren.